




REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Malishevës  
Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë



PRILMAR MË: 31-01-2023  
ACCEPTED ON:  
PRILMAR NO: 06/108  
Nr.No.Br.

RAPORTI VJETOR I PUNËS

Raporti i Punës - Janar Dhjetor 2022

Malishevë

1/31/2022

Për: Kryetarin e Komunës së Malishevës Z. Ekrem Kastrati

Nga: Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Drejtori – Bashkim Krasniqi

Adresa: Rr. "Skenderbeu" P.nr

|                                                                      |    |
|----------------------------------------------------------------------|----|
| <b>Përmbajtja</b>                                                    |    |
| Shkurtesat.....                                                      | 3  |
| Hyrje .....                                                          | 3  |
| Përshkrime të përgjithshme për fushën e veprimit të drejtorisë ..... | 4  |
| Ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret.....                | 5  |
| Përshkrimi i punëve dhe aktiviteteve.....                            | 6  |
| <b>SEKTORËT E DREJTORISË</b> .....                                   | 7  |
| Sektori i Gjeodezisë .....                                           | 7  |
| Sektori i Kadastrit.....                                             | 8  |
| Sektori i Pronës .....                                               | 11 |

## Shkurtesat

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor

AKK – Agjencia Kadastrale e Kosovës

AKP – Agjencia Kosovare e Privatizimit

ZKK – Zyra Kadastrale Komunale

## Hyrje

Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, në përputhje me mandatin e saj ligjor ka arritur të realizoj pjesën me të madhe të objektivave të parapara për vitin 2022. Në fillim të kësaj periudhe janë vendosur në prioritet kërkesat dhe lëndët e papërfunduara gjatë vitit paraprak, shqyrtimi i të gjitha kërkesave brenda afatit të rregullt ligjor, thellimi i bashkëpunimit me të gjitha departamentet në Komunën e Malishevës si dhe organet tjera relavante në nivel qendror.

Janë bërë shumë reforma në infrastrukturen ligjore me anë të udhëzimeve administrative nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës të cilat kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e efikasitetit të punës në sektorin e gjeodezisë dhe kadastrit.

Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë brenda saj ka tre sektorë të cilët dallojnë për nga lloji i shërbimeve dhe lëndëve që janë kompetente për t'i shqyrtuar. Ka numër dhe lloje të ndryshme të kërkesave që kryhen në këtë drejtori si: kërkesa për ndërrim pronari, regjistrim dhe fshirje të hipotekave, kërkesa për ndarje dhe bashkim të parcelave, kërkesa tereni nga kryesitë e fshatrave, kërkesa për rilevim të pronave publike, kërkesa për historiate të parcelave, si dhe kërkesa tjera shtesë nga departamentet tjera brenda administratës komunale.

## Përshkrime të përgjithshme për fushën e veprimit të drejtorisë

- Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, kryen punë profesionale dhe shërbime tjera subjekteve të ndryshme, është përgjegjëse për zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, rrjetën referuese homogjene, për sigurimin e hartave Orto-Foto, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ mbi tokën dhe pronën;
- Planifikimi i rrjetit me pika të reja kontrolluese dhe themelimi i pikave të reja;
- Vektorizimi i planeve të skanuara-ngastrave dhe zonave kadastrale;
- Azhurnimi i pjesës grafike në bazë të dokumenteve dhe matjeve të reja;
- Ndarja e ngastrave dhe shënimi i kufinjeve në rastin e shpronësimit, kryen procedurat e përgatitjes së dokumentacionit rreth shpronësimit të tokës;
- Regjistrimi i pronës së paluajtshme në regjistrat e tokës;
- Zhvillon procedurat e regjistrimit sipas detyrës zyrtare dhe zhvillon procedurat e regjistrimit sipas kërkesës së palëve;
- Bënë korrigjimin e regjistrit lidhur me regjistrimin e pronës sipas ligjeve në fuqi;
- Bënë azhurnimin e pronës në bazë të dokumenteve të verifikuara, azhurnimi i regjistrit të ndërrimeve të matjeve nga terreni;
- Regjistrimin e hipotekës;
- Regjistrimin e servituteve;
- Regjistrimin e pronës dhe objekteve;
- Regjistrimin e pronës së dhënë në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër;
- Lëshon certifikata të pronësisë, kopje plani;
- Mbron pronën komunale-publike nga uzurpimet dhe udhëheqë procedurat lidhur me këtë çështje, etj

**Ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret**

Të gjitha procedurat dhe veprimet në kuadër të kësaj drejtorie janë të rregulluara e të mbështetura me dispozita ligjore të paraqitura si më poshtë:

- Ligji Nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme;
- Ligji Nr. 2003/13 mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligji Nr. 2002/5 mbi Themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme;
- Ligji Nr. 04/L-009 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligji Nr. 2002/5 mbi Themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme;
- Ligji nr. 04/L-013 për Kadastër;
- Ligji Nr. 2002/4 për Hipotekat;
- Ligji mbi Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pronëso-ro-Juridike të Krijuara me Uzurpim Arbitrarë të Tokës në Pronësi Shoqërore (GZ. nr. 46/77);
- Ligji me Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit mbi Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pronëso-ro - Juridike të Krijuara me Uzurpim Arbitrarë të Tokës në Pronësi Shoqërore (GZ. nr. 37/88);
- Ligji mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L – 031;
- Udhëzim Administrativ Nr. MSHP2004/03 për Zbatimin mbi Themelimin e Regjistrit për të Drejtat në Pronën e Paluajtshme;
- Udhëzim Administrativ Nr. 02/2013 për Zbatimin e Ligjit për Kadastër;
- Udhëzim Administrativ (MEA) nr. 09/2020 për Tarifat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme
- Udhëzim Administrativ MMPH nr 08-2019 për Tarifat e Produkteve dhe Shërbimeve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës
- Udhëzim Administrativ MMPH – nr 09-19 për Ndarjen e Zonave Kadastrale
- Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 10/2019 për Matjet kadastrale për Regjistrim në Kadastër;
- Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 11/2019 për Ndarjen e Ndërtesës dhe Pjesëve të Ndërtesës;
- Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 12/2019 për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës;
- Udhëzim Administrativ (MMPH) nr 13-2019 për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe të Gjeodetëve
- Korniza për Punë Nr. AKK 2013/01 për Korrigjimin e Sipërfaqeve;
- Rregullorja për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoka Komunale për Vitin 2017, Nr. 02/80;
- Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 08/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 03/2016 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në emër të dy Bashkëshortëve;

## Përshkrimi i punëve dhe aktiviteteve

Në këtë periudhë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, ka zhvilluar shumë aktivitete duke u bazuar në detyrat dhe obligimet që i takojnë. Në kuadër të këtyre detyrave dhe obligimeve ka kryer këto aktivitete: takime zyrtare me institucionet përkatëse siç është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, Agjencinë Kadastrale të Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe institucione tjera. Pastaj aktivitete tjera në terren në tërë territorin e komunës sonë aty ku është kërkuar që të jemi në shërbim të qytetarëve si dhe aktiviteteve që kanë qenë të nevojshme për Komunën. Gjithashtu janë kryer të gjitha shërbimet që janë kërkuar nga qytetarët në zyrat tona siç janë paisja me certifikata të pronës, kopje të planit dhe të gjitha shërbimet që kryhen në përgjegjësinë e kësaj drejtorie.

Kjo drejtori do të vazhdojë me aktivitetet e saj pa ndërprerë në kuadër të detyrave që të jemi sa më efikas në shërbim të qytetarëve, si dhe institucioneve të ndryshme në Republikën e Kosovës që kanë korrespondencë me këtë drejtori.

Në kuadër të përgjegjësiwe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, përkatësisht stafi i kësaj drejtorie, ka qenë në nivel të detyrave, duke shqyrtuar dhe miratuar të gjitha kërkesat e palëve, e institucioneve, që kanë të bëjnë me ndërrim pronari, regjistrim dhe çregjistrim i hipotekës, regjistrim i servitutit, kërkesa për certifikata të pronës, kopje plani, kërkesa për ndarje dhe bashkim parcelash, etj.

Njëkohësisht i jemi përgjigjur të gjitha kërkesave nga Drejtoria e Inspektoratit të cilat kanë të bëjnë më dyshime për uzurpim, vërtetim të gjendjes faktike dhe kërkesa nga Drejtoria e Urbanizmit që lidhen me realizimin projekteve komunale.

Gjatë vitit 2022 është bërë regjistrimi në regjistra kadastral i Vendimeve Përfundimtare për shpronësim në Autostraden Gjurgjicë – Kijevë dhe Morinë – Merdare në territorin e Komunës së Malishevës, përkatësisht në Zonat Kadastrale Kijevë, Mleqan, Llozicë, Balincë, Carrallukë, Shkarashnik, Tërpezë, Lladroc, Banjë, Bellanicë dhe Temeqinë.

Janë shqyrtuar edhe shumë kërkesa të ndryshme të bëra nga qytetarët dhe përfaqësuesit e fshatrave.

## Sektorët e Drejtorisë

Në kuadër të DGJKP-së, puna dhe procedurat janë të shpërndara në tre sektor: sektori i kadastrit, sektori i gjeodezisë dhe sektori i pronës.

Sektori i Gjeodezisë - është sektori ku palët kanë mundësi që ta shohin gjendjen e pronave të tyre në pjesën grafike, të bëjnë kërkesa të ndryshme për ndarje, bashkim parcelash, matje të ndryshme, kërkesa për koordinata, korrigjime, barazime të pjesës grafike me pjesën tekstuale, paisijen me kopje plani, etj. Po ashtu ky sektor realizon bashkëpunime me drejtori tjera aty ku paraqitet nevoja që të bëhen incizime dhe konstatime ne terren.

Pasqyrimi i punëve dhe numrit të kërkesave të pranuar dhe shqyrtuara në sektorin e gjeodezisë:

### Përiudha Janar – Qershor 2022

| Lloji i kërkesave           | Janar     | Shkurt    | Mars      | Prill     | Maj       | Qershor   | Të hyrat €    |
|-----------------------------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|---------------|
| Kopje plani                 | 20        | 20        | 11        | 15        | 10        | 24        | 625           |
| Koordinata                  | 14        | 14        | 9         | 10        | 14        | 12        | 926           |
| Historiate                  | 1         | 1         | 1         | 2         | 3         | 1         | 90            |
| Ndarje të ngastrave         | 4         | 11        | 1         | 5         | 5         | 9         | /             |
| Kërkesa fshati              | /         | /         | 2         | 1         | 2         | /         | /             |
| Korigjim sipas det. zyrtare | 1         | /         | 6         | 10        | /         | /         | /             |
| Bashkim i ngastrave         | 3         | /         | /         | /         | /         | /         | /             |
| Kërkesa zyrtare             | 3         | /         | 3         | 4         | 1         | 4         | /             |
| Propozim për Urbanizëm      | 1         | 2         | 2         | 2         | /         | 2         | /             |
| <b>Totali</b>               | <b>47</b> | <b>48</b> | <b>35</b> | <b>49</b> | <b>35</b> | <b>52</b> | <b>1641 €</b> |

### Përiudha Korrik – Dhjetor 2022

| Lloji i kërkesave           | Korrik    | Gusht     | Shtator  | Tetor     | Nentor    | Dhjetor   | Të hyrat €    |
|-----------------------------|-----------|-----------|----------|-----------|-----------|-----------|---------------|
| Kopje plani                 | 51        | 9         | /        | 10        | 11        | 11        | 372           |
| Koordinata                  | 17        | 28        | /        | 15        | 7         | 11        | 1810          |
| Historiate                  | /         | 2         | /        | 2         | /         | /         | 120           |
| Ndarje të ngastrave         | 2         | 7         | /        | 2         | 2         | /         | /             |
| Kërkesa fshati              | 1         | /         | /        | 2         | /         | /         | /             |
| Korigjim sipas det. zyrtare | 4         | /         | /        | 3         | 3         | /         | /             |
| Bashkim i ngastrave         | /         | /         | /        | /         | /         | 1         | /             |
| Kërkesa zyrtare             | 4         | 2         | 1        | 3         | 3         | 1         | /             |
| Propozim për Urbanizëm      |           | /         | /        | 10        | 4         | 6         | /             |
| <b>Totali</b>               | <b>79</b> | <b>48</b> | <b>1</b> | <b>47</b> | <b>30</b> | <b>30</b> | <b>2302 €</b> |

|                                                           |        |
|-----------------------------------------------------------|--------|
| Numri i përgjithshëm i kërkesave në sektorin e gjeodezisë | 501    |
| Të hyrat e realizuara në sektorin e gjeodezisë            | 3943 € |

Sektori i Kadastrit – ky sektor bënë pranimin e lëndëve të cilat kanë të bëjnë me regjistrime dhe ndryshime në regjistra kadastrale të cilat bëhen në bazë të akteve të ndryshme juridike, vendimeve gjyqësore, vendimeve administrative apo kontratave të ndryshme, regjistrimi i hipotekave, servituteve, objekteve, etj. Për secilin shërbim me udhëzime administrative dhe rregullore janë të parapara tarifat. Pasi zyrtarët e kadastrit pranojnë lëndën, e njëjta shqyrtohet nëse është e pakompletuar atëherë me shkrim njoftohet pala për plotësim lende dhe pas plotësimit merret vendimi për aprovim, për ndryshimet e nevojshme në regjistra.

Po ashtu ky sektor lëshon dokumente të ndryshme kadastrale si certifikata të pronës, certifikatë që nuk posedon pasuri të paluajtshme.

Pasqyrimi i punëve të shërbimi i kadastrit (Janar – Qershor 2022)

| Muaji          | Fp.p       | Flp.zyr.    | Flp.s    | C.p       | C.s        | Gjithsejt | Fl.p        | Cer.       | F.sh.€     | C.sh.€     | Gjithsejt     |
|----------------|------------|-------------|----------|-----------|------------|-----------|-------------|------------|------------|------------|---------------|
| Janar          | 36         | 211         | 2        | 15        | 23         |           | 249         | 38         | 144        | 45         | 189           |
| Shkurt         | 31         | 150         | /        | 10        | 35         |           | 181         | 45         | 124        | 30         | 154           |
| Mars           | 23         | 285         | /        | 13        | 37         |           | 308         | 50         | 92         | 39         | 131           |
| Prill          | 50         | 208         | 1        | 12        | 27         |           | 259         | 39         | 200        | 36         | 136           |
| Maj            | 47         | 345         | /        | 8         | 62         |           | 392         | 70         | 188        | 24         | 212           |
| Qershor        | 44         | 229         | 3        | 9         | 32         |           | 276         | 41         | 176        | 27         | 203           |
| <b>Totali:</b> | <b>231</b> | <b>1428</b> | <b>6</b> | <b>67</b> | <b>216</b> |           | <b>1665</b> | <b>283</b> | <b>924</b> | <b>201</b> | <b>1125 €</b> |

Korrik – Dhjetor 2022

| Muaji          | Fp.p       | Flp.zyr.   | Flp.s    | C.p       | C.s        | Gjithsejt | Fl.p       | Cer.       | F.sh.€     | C.sh.€     | Gjithsejt     |
|----------------|------------|------------|----------|-----------|------------|-----------|------------|------------|------------|------------|---------------|
| Korrik         | 62         | 70         | 2        | 10        | 45         |           | 134        | 55         | 248        | 30         | 278           |
| Gusht          | 27         | 45         | /        | 12        | 51         |           | 72         | 63         | 108        | 36         | 144           |
| Shtator        | 14         | 29         | 1        | 2         | 57         |           | 44         | 59         | 56         | 6          | 62            |
| Tetor          | 32         | 46         | /        | 13        | 88         |           | 78         | 101        | 128        | 39         | 167           |
| Nentor         | 42         | 103        | /        | 11        | 68         |           | 145        | 79         | 168        | 33         | 201           |
| Dhjetor        | 37         | 32         | /        | 14        | 65         |           | 69         | 79         | 148        | 42         | 190           |
| <b>Totali:</b> | <b>214</b> | <b>325</b> | <b>3</b> | <b>62</b> | <b>374</b> |           | <b>542</b> | <b>436</b> | <b>856</b> | <b>186</b> | <b>1042 €</b> |

|                                                    |               |
|----------------------------------------------------|---------------|
| Numri i përgjithshëm i kërkesave për dokumentacion | <b>2926</b>   |
| Të hyrat e realizuara                              | <b>2167 €</b> |

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur numri dhe lloji e lëndëve sipas sistemit kadastral të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, që është në përdorim nga të gjitha Zyret Kadastrale Komunale në nivel vendi.


# **RAPORTI VJETOR PËR LËNDET NË SIKTK 2022**

| Lloji i lëndës                                             | Komuna    | Total | Lëndet e<br>Aprovuara | Lëndet e<br>Refuzuara | Lëndet e<br>Procesuara |
|------------------------------------------------------------|-----------|-------|-----------------------|-----------------------|------------------------|
| Bartja e posedimit - Ndarje fizike                         | Malishevë | 6     | 5                     | 0                     | 1                      |
| Bartja e posedimit - Blerje                                | Malishevë | 158   | 149                   | 0                     | 9                      |
| Bartja e posedimit - Dhurim                                | Malishevë | 136   | 132                   | 0                     | 4                      |
| Bartja e posedimit - Këmbim                                | Malishevë | 7     | 7                     | 0                     | 0                      |
| Bartja e posedimit - Shpronësim                            | Malishevë | 13    | 13                    | 0                     | 0                      |
| Bartja e posedimit - Trashëgimi                            | Malishevë | 38    | 35                    | 0                     | 3                      |
| Bartja e posedimit Aktgjykim dhe fitime tjera të posedimit | Malishevë | 17    | 11                    | 1                     | 5                      |
| Bartja e pronësisë - Shpronësim                            | Malishevë | 1     | 1                     | 0                     | 0                      |
| Bartja e pronësisë Aktgjykim dhe fitime tjera të pronësisë | Malishevë | 2     | 2                     | 0                     | 0                      |
| Bartja e qiramarrjes te qiramarrësi i ri                   | Malishevë | 4     | 4                     | 0                     | 0                      |
| Bashkim i parcelave                                        | Malishevë | 41    | 40                    | 0                     | 1                      |
| Bashkimi i personave të njëjtë me ID te ndryshme           | Malishevë | 12    | 12                    | 0                     | 0                      |
| Fshirja e drejtës së shfrytëzimit                          | Malishevë | 3     | 3                     | 0                     | 0                      |
| Fshirja e hipotekës pas skadimit të afatit                 | Malishevë | 56    | 55                    | 1                     | 0                      |
| Fshirja e ngarkesës tatimore sipas vendimit të ATK         | Malishevë | 3     | 3                     | 0                     | 0                      |
| Fshirja e qiramarrjes sipas marrëveshjes                   | Malishevë | 1     | 1                     | 0                     | 0                      |
| Fshirja e qiramarrjes sipas vendimit të gjykatës           | Malishevë | 1     | 1                     | 0                     | 0                      |
| Fshirja e vërejtjes me vendim të gjykatës                  | Malishevë | 2     | 2                     | 0                     | 0                      |
| Modifikimi atributëve të parces                            | Malishevë | 70    | 68                    | 2                     | 0                      |
| Modifikimi i atributëve të pjesës së ndërtesës             | Malishevë | 5     | 4                     | 0                     | 1                      |
| Modifikimi i hipotekës                                     | Malishevë | 1     | 1                     | 0                     | 0                      |
| Modifikimi i Servitutit                                    | Malishevë | 1     | 1                     | 0                     | 0                      |
| Modifikimi i të dhënave të personit pa njësi kadastrale    | Malishevë | 18    | 17                    | 1                     | 0                      |
| Modifikimi i të drejtave                                   | Malishevë | 5     | 5                     | 0                     | 0                      |
| Modifikimi i vërejtjes                                     | Malishevë | 1     | 1                     | 0                     | 0                      |
| Ndarje të parcelës                                         | Malishevë | 161   | 154                   | 3                     | 4                      |
| Ndarja e pjesës së ndërtesës                               | Malishevë | 1     | 0                     | 1                     | 0                      |
| Regjistrimi (krijimi) i parcelës së re                     | Malishevë | 1     | 0                     | 0                     | 1                      |
| Regjistrimi i hipotekës                                    | Malishevë | 47    | 44                    | 2                     | 1                      |
| Regjistrimi i ndërtesës                                    | Malishevë | 10    | 9                     | 0                     | 1                      |
| Regjistrimi i ngarkesës tatimore                           | Malishevë | 2     | 2                     | 0                     | 0                      |
| Regjistrimi i qiramarrjes                                  | Malishevë | 1     | 1                     | 0                     | 0                      |
| Regjistrimi i servitutit                                   | Malishevë | 9     | 2                     | 0                     | 7                      |
| Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit                   | Malishevë | 1     | 1                     | 0                     | 0                      |
| Regjistrimi i vërejtjes me kërkesë të palës                | Malishevë | 2     | 2                     | 0                     | 0                      |
| Regjistrimi i vërejtjes me vendim të gjykatës              | Malishevë | 12    | 11                    | 0                     | 1                      |
|                                                            |           | 849   | 799                   | 11                    | 39                     |
| <b>Të hyrat e realizuara: 54,174.75 EURO</b>               |           |       |                       |                       |                        |

Numri i përgjithshëm i kërkesave dhe të hyrave të realizuara gjatë intervalit kohor Janar – Dhjetor 2022 nga të gjithë sektorët e drejtorisë:

|                                                                        |                    |
|------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| <b>Numri i përgjithshëm i kërkesave (lëndëve) Janar – Dhjetor 2022</b> | <b>4276</b>        |
| <b>Të hyrat e realizuara Janar – Dhejtor 2022</b>                      | <b>60,284.75 €</b> |

Me anë të tabelave grafike të mëposhtme kemi paraqitur një krahasim të punëve gjegjësisht kërkesave dhe të hyrave të realizuara ndër vite.



Sektori i Pronës - sektori i pronës zhvillon procedura të ndryshme që kanë të bëjnë me uzurpime të pronës komunale, pranon kërkesa nga përfaqësues të fshatrave që kanë të bëjnë me hapjen e ndonjë rrugë nëpër prona private dhe regjistrimin e saj në kadastrë, zhvillon procedura për këmbimin e pronës publike me pronë private sipas vendimeve administrative, përgatitë lëndët për procedurë të shpronësimit, pranon kërkesa dhe jep kopje të lëndëve të vjetra të cilat janë të arkivuara në këtë sektor si dhe punë shtesë sipas nevojave dhe kërkesave edhe nga drejtori tjera.

Shërbimi pronësoro – juridik ka filluar rilevimet e pronës publike nëpër shumë lokalitete, me theks të veçantë në qytetin e Malishevës, si dhe rilevime në lokacione të ndryshme sipas kërkesave dhe ankesave të palëve, dhe për këto lëndë janë inicuar dhe zhvilluar mbi 100 procedura administrative për shqyrtimin e marrëdhënieve pronësoro juridike të krijuara me uzurpim arbitrar të pronës shoqërore. Këto raste kryesisht kanë qënë të fokusuar në rrugët kryesore të qytetit të Malishevës, me qëllim që ta kemi një pasqyrë me të mirë për realizimin e projekteve kapitale dhe ruajtjes së hapsirave publike.

Në bashkëpunim me shërbimin e kadastrit dhe gjeodezisë është bërë regjistrimi në regjistra kadastral i Vendimeve Përfundimtare për shpronësim në Autostraden Gjurgjicë – Kijevë dhe Morinë – Merdare në territorin e Komunës së Malishevës, përkatësisht në Zonat Kadastrale Kijevë, Mleqan, Llozicë, Balincë, Carrallukë, Shkarashnik, Tërpezë, Lladroc, Banjë, Bellanicë dhe Temeqinë.

Mbetet sfidë numri i vogël i punëtorëve në këtë sektor gjë që ndikon shumë në mbarëvajtjen e punëve dhe zhvillimin efikas të procedurave si dhe mos reformimi i infrastrukturës ligjore që ka të bëjë me trajtimin e uzurpimeve dhe mbrojtjen e pronës komunale e publike.

Këto janë aktivitetet dhe punët e realizuara gjatë kësaj periudhe.

Mbesim të përkushtuar në rritjen e efikasitetin në punë dhe ofrimin e shërbimeve në afatin optimal kohor.

Malishevë

31/01/2023

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronë

Drejtori Bashkim Krasniqi

